



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit
Municipality Assambly of Hani Elezit

01/ Nr. 469/2012

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 të shpallur në Gazetën Zyrtare Nr. 28/2008 nenit 40, Rregulloren e Punës së Kuvendit nenit 15, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur më datë 30.01.2012 mori:

V E N D I M

P Ë R

HEQJEN E SHPENZIMEVE TË VARRIMIT

I

Kuvendi i Komunës miratoi propozim vendimin me numër 02/469/2012 për Heqjen e shpenzimeve të varrimit për të gjitha rastet mortore në Komunën e Hanit të Elezit.

II

Në bazë të diskutimeve në mes të BI (Bashkësisë Islame), dega në Han të Elezit, shpenzimet e varrimit që bëhen me rastin e vdekjes së një individi janë në vlerë prej 170 €.

III

Shpenzimet e varrimit nga pika II e këtij vendimi janë si në vijim:

- Lajmërimi
- Pastrimi i Xhenazes
- Dërrasat e varrimit
- Mbështjellësi (qefini)
- Falja e xhenazes
- Çertifikata e Vdekjes

IV

Mjetet do të merren nga kategoria për Mallra dhe Shërbime në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

V

Pagesa e shpenzimeve do të bëhet çdo tre muaj nga Komuna e Hanit të Elezit në bazë të numrit të vdekjeve.

VI

Shpenzimet që do të hiqen me rastin e vdekjes së një individi do të dëshmohen me prezantimin e certifikatës së vdekjes nga Bashkësia Islame.

VII

Me këtë vendim qytetarët nuk lirohen nga pagesa e anëtarësisë së Bashkësisë Islame.

VIII

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit dhe pas nënshkrimit të marrëveshjes në mes Komunës dhe Bashkësinë Islame, dega në Han të Elezit.

IX

Më këtë Vendim njoftohen: Drejtorja e Shërbimeve Publike, Bashkësinë Islame dega në Han të Elezit, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit:
Data: 01.02.2012

Kryesuesi i Kuvendit
Mënduh Vlasi

